



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05- 231
Podujevë,
21.09.2018

FTESË PËR OFERTË (EKSKURSION)

Bazuar në Ligjin për transportin rrugor nr. 04/L – 179 neni 28, UA 06/2015 të MI për lëshimin e lejeve për kryerjen e transportit të rregullt ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve, qasje dhe kalim transit nëpër territorin e Kosovës, UA (MASHT) për aktivitetet jashtëshkollore 02/2016, të datës 12.01.2016, neni 11, MASHT dhe kërkesave të shkollave të mesme të larta të listuara më poshtë, ftojmë agjencitë turistike që të konkurrojnë për organizimin e ekskursionit për maturantët e Komunës së Podujevës, në Republikën e Shqipërisë, për shkollat:

- Gjimnazi “ Aleksandër Xhuvani “ -Podujevë
- SHMLT “ Fan S. Noli “-Podujevë
- SHMLE “ Isa Boletini “-Podujevë

Ekskursioni organizohet për 4 (katër) bujtje dhe 5 (pesë) ditë kalendarike .

Ofertuesi (agjencioni turistike) duhet t'i plotësojë këto parakushte

1. Të jetë i licencuar,
2. Të ketë bërë kontrollimin teknik sipas procedurave ligjore,
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës,
4. Autobusët të jenë komform dhe të kenë klimë,
5. Të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusëve
6. Të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut), si dhe të

paraqesë këto dokumente :

1. Licencën nga Ministria e Postë-Telekomunikacionit, me licencë A,B, D
2. Çdo autobus duhet të posedojë certifikatën në bazë të këtyre licencave A,B,D
3. Çdo vozitës duhet të jetë i certifikuar me CPC(certifikata e kompetencës profesionale),
4. Gjendjen teknike të autobusëve brenda 6 muajsh ,
5. Çmimet e plota të pansioneve,
6. Menynë e ushqimit ditor,
7. Imazhin e agjencisë - referenca për organizime të ekskursioneve me nxënësit të shkollave të mesme të Kosovës (e preferuar referencat – kontratat me shkollat e mesme të komunës së Podujevës ku edhe ofertojnë si dhe kontrata me hotele)
8. Dokumentacionin plotësues (kontratë me mjekun e mjekësisë familjare)

9. Të ketë dokumentacionin – licencën e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve

Aplikuesit duhet të aplikojnë për secilën shkollë individualisht.

Dokumentacioni dorëzohet në Drejtorinë e Arsimit, deri më 28.09.2018, në orën 13.30.

Hapja e ofertave bëhet më 28.09.2018, në orën 14.00.

u.d.drejtori
Agim Blakçori

